

Afati përfundimtar i dorëzimit të komenteve me shkrim në kuadër të procesit të konsultimit publik për Projektligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, është deri më 30.12.2016. Të gjitha komentet e pranuar brenda afatit do të shqyrtohen. Të gjitha komentet me shkrim duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: ardian.bajraktarai@rks-gov.net.

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR PËRGJEGJËSINË DISIPLINORE TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi dhe Fushëveprimi

Me këtë ligj përcaktohet shkelja disiplinore, procedura e inicimit të hetimit të shkeljeve disiplinore të pretenduara të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedura e hetimit, procedurën disiplinore para Komisioneve Disiplinore përkatëse, procedurën para Këshillave dhe Gjykatës Supreme, si dhe organizimi, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës për Përgjegjësi Disiplinore (më tej: Zyra).

KAPITULLI II PËRGJEGJËSIA, SHKELJET DHE MASAT DISIPLINORE PËR GJYQTARË DHE PROKURORË

Neni 2 Përgjegjësia Disiplinore

1. Gjyqtarët dhe prokurorët i nënshtrohen përgjegjësisë disiplinore në rastet dhe me procedurat e përcaktuara në këtë ligj.

2. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë përgjegjësi disiplinore për shkelje të këtij ligji dhe për kryerjen e veprimeve e të sjelljeve që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tyre, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Kodit të Etikës për gjyqtarë dhe prokurorë.

Neni 3

Shkeljet disiplinore për Gjyqtarë

1. Shkeljet disiplinore për gjyqtarë ndahen në shkelje:

1.1. të lehta;

1.2. të rënda; dhe

1.3. shumë të rënda.

2. Shkelje të lehta konsiderohen veprimet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, të cilat i atribuohen qartë veprimeve të gjyqtarit, si në vijim:

2.1. vonesa e paarsyeshme në caktimin e seancës gjyqësore, e cila është rezultat i drejtpërdrejtë i sjelljes së dukshme dhe të pafalshme të gjyqtarit, me veprim ose mosveprim me dashje ose me pakujdesi, që rezulton në dëm të identifikueshëm të palës;

2.2. mungesa e paarsyeshme dhe pa paralajmërim në punë deri në tre (3) ditë;

2.3. mos respektimi i rregullave të mbarëvajtjes së punës, që nënkupton por nuk kufizohet në, respektimin e orarit të caktuar për zhvillimin e seancës gjyqësore, sigurimin e rendit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore, mbajtjen e togës së posaçme nga vetë gjyqtari, avokatët dhe prokurorët dhe veshjes serioze e të përshtatshme të pjesëmarrësve të tjerë në sallë, të cilat vazhdimisht dhe seriozisht shkelin Kodin e etikës ose sjellja e pajustificueshme që direkt i atribuohet gjyqtarit;

2.4. nëse gjatë orarit të punës kryen veprimtari që nuk ndërlidhen me funksionin e gjyqtarit;

2.5. komunikimi ex-parte me palët pjesëmarrëse në procedurë gjatë periudhës së gjykimit.

3. Shkelje të rënda konsiderohen veprimet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, të cilat i atribuohen qartë veprimeve të gjyqtarit në vijim:

3.1. përsëritja e vazhdueshme e shkeljeve të përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni;

3.2. ndërhyrja ose çdo lloj ndikimi tjetër në ushtrimin e detyrës tek një gjyqtar ose zyrtar tjetër;

3.3. shkelja e Kodit të Etikës për gjyqtar në marrëdhëniet me palë në procedurë, si kolegët, kryetarin e gjykatës, stafin e administratës gjyqësore, ekspertët, prokurorët, avokatët;

3.4. bërja publike e dokumenteve zyrtare, të dhënave apo regjistrimeve me karakter sekret ose konfidencial;

3.5. pengimi i funksioneve të inspektorateve në veprimtarinë e tyre të ligjshme;

3.6. kryerja e një shkeljeje të lehtë, kur gjyqtari ka qenë më parë i sanksionuar me vërejtje me paralajmërim për një shkelje tjetër të lehtë, e cila nuk është parashkruar;

3.7. shfrytëzimin e pozitës së gjyqtarit, duke përfshirë por pa u kufizuar në statusin apo pozitën, në sigurimin e trajtimit të veçantë;

3.8. vonesa e paarsyeshme në përpilimin e vendimit gjyqësor duke llogaritur nga dita e tejkalimit të afatit ligjor;

3.9. refuzim pa arsye për kryerjen e detyrave;

3.10. mos bërja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, kur kjo është e detyrueshme, sipas Kodit të Procedurës Penale dhe legjislacionit civil në fuqi;

3.11. refuzimi i zbatimit të masës disiplinore;

3.12. bërja e ditur e mendimeve që janë dhënë gjatë seancave të gjykimit, që akoma nuk kanë marrë formën e një vendimi;

3.13. mos bërja e kërkesës për heqje dorë nga gjykimi në rastet ku mund të ngrihen dyshime lidhur me pavarësinë apo paanësinë e gjyqtarit;

4. Shkelje shumë të rënda konsiderohen veprimet dhe sjelljet që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, të cilat i atribuohen qartë veprimeve të gjyqtarit në vijim:

4.1. anëtarësimi në parti politike,

4.2. pjesëmarrja në veprimtari me karakter partiak;

4.3. pjesëmarrja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë në administrimin apo drejtimin e shoqërive tregtare, ose organizatave jo qeveritare të cilat nuk janë relevante për qëllime profesionale personalisht ose me anë përfaqësimit;

4.4. të jetë ekspert ose arbitër në arbitrazh;

4.5. të bëjë deklaratë në publik që cenojnë paanshmërinë e procesit gjyqësor;

4.6. mosndërmarrja e veprimeve procedurale dhe mos marrja e vendimeve brenda afateve të përcaktuara me ligj në mënyrë të vazhdueshme;

4.7. kryerja e një shkeljeje të rëndë, kur gjykatësi ka qenë më parë i dënuar për një shkelje tjetër të rëndë, e cila nuk është parashkruar;

4.8. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale për personin e tretë;

4.9. shfrytëzimi në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë i pozitës së gjyqtarit me qëllim të përfitimit të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale të cila i jepen për shkak detyrës;

4.10. dënimin për vepër penale me aktgjykim të plotfuqishëm.

5. Shkelja disiplinore nuk përfshin pretendimet që ndërlidhen drejtpërdrejt me meritat e vendimit të gjyqtarit.

Neni 4

Shkeljet Disiplinore për Prokurorë

1. Shkelje disiplinore për prokuror janë si në vijim:

1.1. mos ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;

1.2. neglizhenca në kryerjen e detyrave apo keqpërdorimi i funksioneve prokuroriale;

1.3. dështimi për të kryer funksionet prokuroriale në mënyrë të pavarur dhe të paanshme në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin;

1.4. shkelja e Kodit të Etikës për Prokurorë;

1.5. nxjerrja e sekretit të hetimit ose e të dhënave të tjera me karakter konfidencial;

1.6. mungesa e paarsyeshme dhe paparaljmërim në punë deri në tre (3) ditë;

1.7. ndërmarrja e veprimeve që, sipas ligjit, janë të papajtueshme me funksionet e prokurorit.

1.8. dënimin për vepër të rëndë penale me aktgjykim të plotfuqishëm sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

2. Pavarësisht nga shkeljet e specifikuar në paragrafin 1 të këtij neni, shkeljet disiplinore për gjyqtarë zbatohen përshtatshmërisht edhe për prokurorë për aq sa mund të zbatohen për punën e tyre.

3. Shkelja disiplinore nuk përfshin pretendimet që ndërlidhen drejtpërdrejt me meritat e vendimit, vendimin procedural apo vendimin e prokurorit.

Neni 5

Masat disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë

1. Masat disiplinore shqiptohen në raport të drejtë me shkeljen e kryer, me vendim të Komisioneve Disiplinore përkatëse në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

2. Masat disiplinore janë:

2.1. vërejtje me shkrim që nuk publikohet;

2.2. vërejtje publike me shkrim;

2.3. ulje e përkohshme e pagës deri në pesëdhjete përqind (50%) për periudhën kohore deri në një (1) vit;

2.4. pezullimi i përkohshëm nga detyra deri në gjashtë (6) pa pagesë:

2.5. propozim për shkarkim nga detyra në pajtim me Kushtetutën.

3. Për shkeljet e lehta të përcaktuara për gjyqtarë sipas këtij ligji mund të shqiptohen masat si në paragrafin 2.1 dhe 2.2 të këtij neni;

4. Për shkeljet të rënda të përcaktuara për gjyqtarë sipas këtij ligji mund të shqiptohen masat si në paragrafin 2.3 të këtij neni;

5. Për shkeljet shumë të rënda, të përcaktuara për gjyqtarë sipas këtij ligji mund të shqiptohen masat si në paragrafin 2.4 të këtij neni;

6. Për shkeljet e përcaktuara për prokurorë sipas këtij ligji mund të shqiptohen përshtatshmërisht masat e përcaktuara si në paragrafin 2 të këtij neni;

7. Për efekt të procedimit disiplinor, masat disiplinore për shkelje të lehta për gjyqtarë shlyhen brenda dy (2) vjetëve nga data e dhënies së tyre, në qoftë se nuk është marr ndonjë masë tjetër disiplinore.

KAPITULLI III PROCEDURA DISIPLINORE

NËNKAPITULLI I PROCEDURA HETIMORE

Neni 6 Inicimi i Procedurës hetimore

1. Zyra, si organ me përgjegjësi për pranimin e parashtresave për përgjegjësi disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë fillon procedurën hetimore sipas detyrës zyrtare ose me paraqitjen e parashtresës nga çdo person fizik apo juridik, të cilat mund të paraqiten në çdo kohë.

2. Komisionin Fillestar do të shqyrtoj parashtresat duke ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme në favor të parashtruesit. Nëse parashtresa tregon pima facies se ka shkelje disiplinore atëherë çështja referohet për hetim.

3. Të gjitha institucionet janë të detyruar t'i përgjigjën kërkesave të Zyrës për ofrimin dhe dhënien e informacioneve, dokumentacionit, deklaratave dhe provave tjera për verifikim e pretendimeve të paraqitura brenda afatit prej tridhjetë (30) ditë pune nga data e pranimit të kërkesës.

4. Mos përgjigja në kërkesën sipas paragrafit 3 të këtij neni nga ana e gjyqtarëve, prokurorëve, kryetarëve të gjykatave dhe kryeprokurorëve të të gjitha niveleve përbën shkelje disiplinore.

Neni 7

Parashkrimi

1. Zyra nuk e fillon procedurën e hetimit për shkelje të lehta dhe të rënda disiplinore, nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga data kur ka ndodhur shkelja e pretenduar.
2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, për shkelje shumë të rënda nuk zbatohen afatet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 8 Parashtresa

1. Parashtresa nënkupton shkresën, e cila mund të paraqitet nga çdo person fizik apo juridik ose informacionin nga çfarëdo burim që i jep Komisionit Fillestar bazë të arsyeshme për të besuar se një gjyqtar apo prokuror ka kryer shkelje disiplinore siç përcaktohet me dispozitat e këtij Ligji. Parashtresat mund të jenë anonime.
2. Parashtresa sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të përmbajë informacion për të identifikuar subjektin e parashtresës dhe një deklaratë koncize që detajon faktet specifike mbi të cilat bazohet pretendimi për shkelje disiplinore si në vijim:
 - 2.1. veprimin që ka ndodhur;
 - 2.2. ku dhe kur kanë ndodhur veprimet përkatëse;
 - 2.3. çdo informacion që do të ndihmonte Zyrën të verifikoj faktet.
3. Kur Zyra ka informacion që përbën arsye të mjaftueshme për hetim se një gjyqtar ose prokuror është angazhuar në shkelje disiplinore mund të kryejë hetim për saktësinë e informacionit edhe nëse nuk është dorëzuar parashtresë, si dhe mund të vazhdoj me shqyrtimin e rastit sipas detyrës zyrtare në pajtim me dispozitat e këtij ligji.
4. Gjitha parashtresat e dorëzuara, nga çfarëdo burimi, duhet të regjistrohen.

Neni 9 Kompetencat e Komisionit Fillestar

1. Komisioni Fillestar përbëhet nga të gjithë inspektorët disiplinor të Zyrës dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm. Pjesëmarrja është e detyrueshme për inspektorët përveç rasteve mungesa është e arsyetuar.
2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi i parashtresës, Komisioni Fillestar i Zyrës, shqyrton parashtresën, vendos për pranueshmërinë e saj dhe cakton inspektorin disiplinor.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, Komisioni fillestar shqyrton pranueshmërinë e parashtresës, sipas kritereve në vijim:
 - 3.1. parashtresa është qartazi e pabazuar,
 - 3.2. parashtresa nuk paraqitet brenda afatit të lejuar, sipas nenit 7 të këtij ligji.

3.3. parashtresa nuk është në kuadër të kompetencave të Zyrës.

4. Pas shqyrtimit të parashtresës Komisioni Fillestar përcakton nëse parashtresa duhet të:

4.1. refuzohet si e papranueshme;

4.2. vendos se parashtresa është e pranueshme dhe procedoj për hetim te inspektori disiplinor.

5. Në pajtim me paragrafin 3 të këtij neni, parashtresa refuzohet në tërësi ose pjesërisht kur Komisioni Fillestar gjen se:

1.1. është e papranueshme sepse nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me këtë ligj;

1.2. është drejtpërdrejt e lidhur me meritat e një vendimi ose vendimi procedural;

6. Në rastet kur Komisioni Fillestar refuzon ankesën si e papranueshme pa caktuar inspektorin disiplinor, atëherë Komisionit Fillestar duhet të përgatisë një arsyetim që paraqet bazën për refuzim.

7. Në rastet kur Komisioni Fillestar vendos se parashtresa është e pranueshme dhe referon rastin për hetim, Zyra duhet të njoftoj parashtruesin dhe subjektin e hetimit në afat prej shtatë (7) ditësh se çështja i është referuar inspektorit disiplinor.

Neni 10 Vepra penale

1. Përgjashtimisht nga neni 9 i këtij ligji në rastet kur Komisioni Fillestar gjen se shkelja e pretenduar ka edhe elemente të veprës penale, rastin në fjalë e referon sipas detyrës zyrtare te prokurori i shtetit si dhe pezullon procedurën e hetimit për shkelje disiplinore.

2. Nëse prokurori i shtetit nuk ndërmer veprimet e ndjekjes penale, kjo nuk e ndalon Zyrën të vazhdoj procedurën e hetimit të shkeljes disiplinore.

3. Referimi i rastit te prokurori i shtetit e ndërprejnë rrjedhjen e afatit të parashkrimit.

Neni 11 Hetimi

1. Qëllimi i hetimit të Inspektorit disiplinor është që të mbledh dhe njihet me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për nxjerrjen e rekomandimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara me Ligjin për Procedurën Administrative.

2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni në rast se një çështje procedurale nuk është e rregulluar me këtë ligj zbatohen përshtatshëmrisht Ligjin për Procedurën Administrative dhe vetëm provat e mbledhura në pajtim me rregullat e Këshillave përkatës do të jenë të pranueshme.

Neni 12

Masa Siguruese

1. Gjatë shqyrtimit të parashtrësës, kur Inspektori Disiplinor vlerëson se pretendimi ka të bëjë me shkelje të rëndë ose shkelje shumë të rëndë, të kryer nga ana e gjyqtarit apo prokurorit, me qëllim të zhvillimit efikas të procesit hetimor dhe mbrojtjes së imazhit të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, i propozon Komisionit Disiplinor të Këshillit përkatës suspendimin me pagesë të subjektit të hetimit.
2. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të jetë i arsyetuar.
3. Palët kundër vendimit kanë të drejtë ankesë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë, si dhe në rast të mos marrjes së vendimit në afat prej tridhjetë ditësh nga dita e paraqitjes së propozimit par masë.
4. Ankesa kundër vendimit mbi masën siguruese nga paragrafi 3 i këtij neni nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 13 Të drejtat e Palëve në Procedurë

1. Subjekti i hetimit duhet të njoftohet nga Zyra me shkrim për:
 - 1.1. caktimin e inspektorit disiplinor;
 - 1.2. pretendimet e specifikuar në parashtrësë dhe t'i jepet mundësia e deklaramentit lidhur me to.
2. Subjekti i hetimit mund të sugjeroj dëshmitarë, të paraqesë prova, si dhe të kërkoj paraqitjen e dokumenteve.
3. Parashtruesi duhet të marrë njoftim me shkrim për caktimin e inspektorit disiplinor lidhur me parashtrësën e tij. Kur parashtrësja paraqitet para ndonjë institucioni tjetër, ky i fundit obligohet që të dërgoj parashtrësën në Zyrë dhe të njoftoj parashtruesin.

Neni 14 Veprimet e Zyrës pas Hetimit

1. Në pajtim me dispozitat e këtij ligji, inspektori disiplinor mund të:
 - 1.1. hedh poshtë ankesën sepse:
 - 1.1.1 shkelja e pretenduar nuk përbën shkelje sipas dispozitave të këtij ligji;
 - 1.1.2. parashtrësja është drejtpërdrejt e lidhur me meritat e një vendimi ose vendimi procedural;
 - 1.1.3 pretendimet mbi të cilat parashtrësja është e bazuar nuk janë vërtetuar.

2. Zyra pas përfundimit të procedurës hetimore i rekomandon Komisioneve Disiplinore të Këshillave përkatës shqiptimin e masës disiplinore sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 15 **Përrjashtimi nga Procedura**

Subjekti i hetimit, i përcaktuar me këtë ligj është i përrjashtuar nga pjesëmarrja në shqyrtimin dhe vendosjen e cdo ankese, me përrjashtim të rasteve që ky ligj parashikon pjesëmarrjen e subjektit të hetimit në procedurë.

Neni 16 **Publikimi i Vendimeve**

1. Komisioni Disiplinor përkatës, Këshilli përkatës dhe Gjykata Supreme bëjnë publike vendimet e tyre përveç në qoftë se është paraparë ndryshe me këtë ligj.
2. Vendimet sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhen publike në pajtim me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Ekzekutimi i vendimeve disiplinore bëhet nga ana e Këshillit përkatës.

Neni 17 **Shpalosja e informacioneve në rrethana të veçanta**

1. Gjykata Supreme, Këshilli përkatës ose Zyra mund të autorizojë shpalosjen e informacioneve në lidhje me shqyrtimin e një parashtrese duke përfshirë letrat, dokumentet dhe procesverbalet që kanë të bëjnë me hetimin, për aq sa zbulimi arsyetohet nga rrethanat e veçanta dhe nuk është i ndaluar me ligj.
2. Shpalosja mund të bëhet për hulumtues të angazhuar në studimin ose vlerësimin e përvojës në bazë të ligjit lidhur me disiplinimin, vetëm në rastet kur studimi ose vlerësimi është miratuar në mënyrë specifike nga Këshilli përkatës.
3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, duhet zbatuar ligji për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Asnjë nga këto rregulla nuk e pengon subjektin e hetimit të pranoj se ai/ajo është subjekti i përmendur në dokumentet e bëra publike sipas ligjit.

Neni 18 **Marrëveshja për Pranimin e Përgjegjësisë**

1. Zyra dhe subjekti i hetimit mund të dakordohen mbi vendosjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore për të cilën subjekti i hetimit është duke u hetuar.
2. Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni marrëveshja nuk zbatohet në rastet e shkeljeve shumë të rënda, për të cilat mund të shqiptohet masa e shkarkimit.

3. Palët do të paraqesin një Marrëveshje për Pranimin e Përgjegjësive Disiplinore, e cila do të reflektoj shkeljet disiplinore të cilat subjekti i hetimit është duke i pranuar.
4. Marrëveshja me shkrim, e nënshkruar nga palët do të dorëzohet tek Komisionet Disiplinore.
5. Në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, Marrëveshja përmban si në vijim:
 - 5.1. deklaratën faktike të shkeljes disiplinore të cilën e pranon subjekti i hetimit;
 - 5.2. masën e dakorduar disiplinore;
 - 5.3. një deklaratë, të nënshkruar nga subjekti i hetimit në fjalë, se është i vetëdijshëm që Marrëveshja duhet të miratohet nga Komisioni Disiplinor.
6. Pas pranimit të Marrëveshjes, Komisioni Disiplinor duhet të pranoj ose refuzoj marrëveshjen.
7. Nëse Komisioni Disiplinor pranon Marrëveshjen, çështja do të procedohet në të njëjtën mënyrë sikur Komisioni Disiplinor të ketë konstatuar se ka ndodhur një shkelje disiplinore, përveç se nuk do të ketë ankesë pas pranimit të Marrëveshjes nga Komisioni.
8. Nëse Komisioni Disiplinor refuzon Marrëveshjen, fakti që palët janë përpjekur të negociojnë një marrëveshje të tillë me zgjidhje vullnetare të shkeljes disiplinore dhe çdo pranim i bërë nga pala para Komisionit nuk mund të përdoret nga ose kundër cilësdo palë në asnjë seancë disiplinore.
9. Në pajtim me paragrafin 7 të këtij neni Zyra mund të filloj, respektivisht të vazhdoj hetimet për shkelje disiplinore ndaj subjektit të hetimit, të përmendur në Marrëveshje brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e refuzimit të marrëveshjes së tillë.

Neni 19 **Rekomandimi**

1. Pasi përfundimit të hetimit, Zyra i rekomandon Komisioni Disiplinor të Këshillit përkatës iniciimin e procedurës disiplinore dhe shqiptimin e masës disiplinore të përcaktuar me dispozitat e këtij ligji.
2. Rekomandimi duhet ti dërgohet me shkrim Komisionit Disiplinor të Këshillit përkatës jo më vonë se pesëmbëdhjete (15) ditë nga data e përfundimit të hetimit.
3. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni rekomandimi duhet të përmbaj të dhënat si në vijim:
 - 3.1. të dhënat e përgjithshme për subjektin e hetimit;
 - 3.2. përmbledhje e të gjeturave duke përfshirë por mos kufizuar në provat dhe faktet që mbështesin pretendimet, si dhe

3.3. propozimin e arsyetuar për shqiptimin e masës disiplinore të përcaktuar me dispozitat e ligjit.

4. Pas pranimit të rekomandimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, Sekretariati përkatës obligohet që të njëjtin së bashku me materialet tjera pa vonesë ta përcjell tek kryetari, anëtarët e Komisionit Disiplinor për shqyrtim, parashtruesi dhe subjekti i hetimit.

Neni 20 **Njoftimi i subjektit të hetimit**

1. Komisioni Disiplinor, pas marrjes së rekomandimit të Zyrës dhe materialeve përkatëse për shkeljen e pretenduar, duhet të njoftoj me shkrim subjektin e hetimit brenda tri (3) ditë pune, për:

- 1.1. natyrën e shkeljës së pretenduar;
- 1.2. paraqitjen e rekomandimit për shqyrtim tek komisioni disiplinor;
- 1.3. kohën dhe vendim ku do të mbahet seanca e komisionit disiplinor, si dhe
- 1.4. mundësinë e subjektit të hetimit për përfaqësim.

NËNKAPITULLI II **PROCEDURA PARA KËSHILLAVE**

Neni 21 **Komisionet Disiplinore të Këshillave**

1. Komisioni Disiplinor i Këshillit Gjyqësor të Kosovës përbëhet nga tre (3) anëtarë të Këshillit, dy (2) nga të cilët duhet të jenë gjyqtarë. Kryesuesi i Komisionit është gjyqtar. Gjyqtarët emërohen nga Këshilli.

2. Komisioni Disiplinor i Këshillit Prokurorial të Kosovës përbëhet nga tre (3) anëtarë, një prej të cilëve është prokuror dhe anëtar i Këshillit, i cili është edhe kryesues i Komisionit. Njëri anëtarë është prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe një anëtarë prokurorë nga Prokuroria e Apelit.

3. Komisioni brenda tridhjetë (30) ditëve prej pranimit të rekomandimit duhet të marrë vendim si në vijim:

- 3.1. vendos për caktimin e seancës dëgjimore lidhur me rastin brenda tridhjetë (30) ditëve;
- 3.2. kërkoj nga inspektori disiplinor dëshmi shtesë, si dhe

3.3. kthej çështjen tek inspektori disiplinor me udhëzime për të kryer hetim shtesë.

Neni 22 **Seancat disiplinore**

1. Pasi që Komisioni Disiplinor i Këshillit përkatës ka marrë rekomandimin për shqiptim të masës disiplinore nga Zyra, gjyqtari apo prokurori që janë subjekt i hetimit do të njoftohen për bazën e procedurës disiplinore dhe do të ftohen nga Komisioni Disiplinor që të paraqiten personalisht në një seancë të mbyllur e cila do të zhvillohet brenda tridhjetë (30) ditëve të punës nga data e njoftimit.
2. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë të drejtën e vet-përfaqësimit apo të caktimit të një mbrojtësi të autorizuar për mbrojtjen e tyre dhe kanë qasje në të gjitha provat e fituara gjatë hetimit dhe në të gjitha shkresat e lëndës.
3. Komisioni disiplinor përkatës vendos nëse është kryer shkelja disiplinore e pretenduar, me c'rast shqipton masën disiplinore sipas dispozitave të këtij ligji.
4. Komisioni disiplinor përkatës mund të kërkoj dëshmi shtesë nga inspektori disiplinor.

Neni 23 **Hetim i mëtejshëm**

1. Nëse Komisioni Disiplinor i Këshillit përkatës gjen se rekomandimi i Zyrës dhe materialet përkatëse nuk sigurojnë bazë të mjaftueshme për nxjerrjen e vendimit, mund të kryej hetime të mëtejshme ose mund të kthej çështjen te Zyra për hetim të mëtejshëm.
2. Nëse Komisioni Disiplinor vendos në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, atëherë duhet paraprakisht ta njoftoj me shkrim subjektin e hetimit.

Neni 24 **Vendimet e Komisioneve Disiplinore**

Vendimi duhet të jetë në formë të shkruar, të përmbajë arsyetimin si dhe këshillën juridike. Një kopje e vendimit do t'i dërgohet gjyqtarit apo prokurorit që janë subjekt i hetimit si dhe Zyrës për Përgjegjësi Disiplinore.

Neni 25 **Ankesa ndaj Vendimit të Komisionit**

1. Ankesat kundër vendimit të Komisionit Disiplinor përkatës mund t'i dërgohet Këshillit përkatës përmes Kryesuesit. Në procesin ankimes nuk mund të marrë pjesë anëtar i Këshillit i cili ka qenë i anëtar i Komisionit.
2. Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi i vendimit të Komisionit Disiplinor, subjekti i hetimit si dhe Zyra mund të ushtrojnë ankesë pranë Këshillit kundër vendimit të Komisionit.

3. Afati për ankesë sipas paragrafit 2 të këtij neni, mund të vazhdohet me kusht që kërkesa për zgjatje të afatit është paraqitur pranë Këshillit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve në dispozicion. Këshilli nuk do të mundësoj asnjë vazhdim të afatit për ankesën e parashtruar pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh, përpos paraqitjes së rrethanave të jashtëzakonshme.

4. Ankesa e ushtruar brenda këtyre afateve kohore pezullon ekzekutimin e vendimit disiplinor.

5. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, në rast se Këshilli nuk merr vendim brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të ankesës, subjekti i hetimit ose Zyra mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën Supreme për mosveprim të Këshillit përkatës.

Neni 26 **Arsyet për ankesë**

1. Ankesa mund të ushtrohet në rrethanat si në vijim:

1.1. shkelja e legjislacionit në fuqi për gjyqtarët dhe prokurorët;

1.2. shkeljet procedurale

1.3. vërtetimi i gabuar gjendjes faktike që ndikon në të drejtat substanciale të palëve, nëse ndikon në integritetin, paanshmërinë apo perceptimin publik të procedurës;

2. Ankesa me shkrim dorëzohet në Këshillin përkatës brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji dhe duhet të përmbajë të dhënat në vijim:

2.1. të dhënat personale të ankuesit;

2.2. vendimi ndaj të cilit ankimohet;

2.3. data e pranimit të vendimit; dhe

2.4. baza e ankesës.

Neni 27 **Vendimi i Këshillit**

1. Vendimi i Këshillit duhet të jetë me shkrim dhe i arsyetuar dhe duhet të nxjerrët brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të ankesës.

2. Këshilli, në takim të hapur vendos me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit.

3. Këshilli gjatë vendosjes për ankesë mund të refuzojë ankesën, të vërtetoj vendimin ose ta kthej në rishqyrtim tek Komisioni Disiplinor.

4. Vendimi sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të jetë i arsyetuar sa i takon provave të administruara nga të dyja palët, interpretimit të shkeljeve të pretenduara, dhe masës së dënimit të argumentuar që do t'i përshtatej arritjes së qëllimit të përcaktuar me këtë ligj. Në

një rast të tillë vendimi i Këshillit duhet të reflektojë, dhe të arsyetojë, zbatimin e parimit të proporcionalitetit në vendosje për çështjen e tillë.

Neni 28 **Ankesa ndaj Vendimit të Këshillit**

1. Ndaj vendimeve të Këshillit përkatës subjekti i hetimit dhe Zyra mund të paraqesin ankesë në Gjykatën Supreme, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e pranimit të vendimit.
2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rast se Këshilli nuk merr vendim brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të ankesës, subjekti i hetimit ose Zyra mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën Supreme për mosveprim të Këshillit përkatës.

NENKAPITULLI III **SHQYRTIMI NGA GJYKATA SUPREME**

Neni 29 **Shqyrtimi nga Gjykata Supreme**

1. Gjykata Supreme, në trup gjykues të përbërë nga tre anëtarë, të zgjedhur nga kryetari i Gjykatës në afat brenda dyzetepesë (45) ditë shqyrton dhe vendos lidhur me ankesat ndaj vendimit të Këshillit përkatës në bazë të këtij ligji. Në rast se Kryetari i Gjykatës është subjekt i hetimit atëherë zgjedhjen e anëtarëve e bën gjyqtari më i moshuar i Gjykatës Supreme.
2. Shqyrtimi i Vendimeve të Këshillit bëhet për shkelje të legjislacionit në fuqi, shkelje procedurale, si dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike apo prova jo të plota.
3. Pas shqyrtimit të ankesës, Gjykata Supreme mund të konfirmoj vendimin e Këshillit, të ndryshoj atë, apo ta kthej mbrapa për rishqyrtim në Këshill.
4. Në rast se Gjykata Supreme vendos ta kthej lëndën në rishqyrtim në Këshillin përkatës, atëherë Këshilli përkatës vendos brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të vendimit sipas udhëzimit të Gjykatës dhe të njoftoj Gjykatën.
5. Në rast se Gjykata Supreme nuk merr njoftim lidhur me vendimin sipas paragrafit 5 të këtij neni brenda afatit dyzetepesë (45) ditë nga dita e kthimit të lëndës për rishqyrtim, atëherë Gjykata Supremen vendos për lëndën në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditë nga kalimi i afatit sipas këtij paragrafi.
6. Vendimi i Gjykatës Supreme është përfundimtar.

KAPITULLI IV **ZYRA PËR PËRGJEGJËSI DISIPLINORE**

Neni 30 **Veprimtaria e Zyrës**

1. Zyra është organ i pavarur i administratës shtetërore në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, në pajtim me Ligjin për Administratën Shtetërore në Kosovë.
2. Zyra në ushtrimin e funksioneve të saj është profesionalisht e pavarur.
3. Zyra është përgjegjëse për kryerjen e punëve në vijim: shqyrtimin e parashtresave, hetimin e shkeljes disiplinore të pretenduar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ti rekomandoj Këshillit Gjyqësor të Kosovës ose Këshillit Prokurorial të Kosovës shqiptimin e masës disiplinore kundër një gjyqtari apo prokurori në bazë të hetimeve të kryera dhe të përfaqësoj Zyrën në procedurat disiplinore në përputhje me këtë ligj.
4. Zyra ka statusin e personit juridik si dhe ka vulën e vet e cila përcaktohet me rregullore të brendshme.
5. Zyra ka pavarësi të plotë në hetimet që bën sipas dispozitave të këtij ligji. Askush nuk mund të ndikojë direkt ose indirekt me hetimet e ndërmarra nga Zyra ose të ndikojë në ndonjë mënyrë tjetër të paligjshme. Ministria e Drejtësisë ushtron mbikqyrje administrative vetë, sa i përket çështjeve administrative dhe për qëllim të respektimit të ligjeve në fuqi.

Neni 31 **Struktura organizative e Zyrës**

1. Organizimi i brendshëm dhe sistematizimi i Zyrës, rregullohet me akt nënligjor, të cilin e miraton Ministri i Drejtësisë në pajtim me Ligjin për administratë shtetërore dhe Ligjin për Shërbimin Civil.
2. Përjashtimit nga paragrafi 1 i këtij neni Kryeinspektori dhe inspektorët disiplinor nuk kanë statusin e nëpunësit civil dhe pranojnë pagë përshtatshëmrisht me Kryeprokurorin përkatësisht prokurorët themelor.

Neni 32 **Drejtori i Zyrës**

1. Drejtori është përgjegjës për menaxhimin efektiv dhe efikas të funksionimit të Zyrës. Drejtori në veçanti do të jetë përgjegjës për:
 - 1.1. dhënien e rekomandimeve për Ministrin e Drejtësisë për çështjet e legjislacionit dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me procedurat disiplinore në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët;
 - 1.2. sigurohet se vendimet e politikave dhe masat e tjera të Ministrisë së Drejtësisë lidhur me procedurat disiplinore në lidhje me gjyqtarët dhe prokurorët të zbatohen në mënyrë efikase dhe efektive;
 - 1.3. menaxhimin e nëpunësve civil dhe punonjësve tjerë të Zyrës;

1.4. menaxhimin e buxhetit të ndarë për Zyrën;

1.5. menaxhimin e rrjedhës së informacionit në gjithë Zyrën duke siguruar koordinim efektiv dhe bashkëpunim në kuadër të Zyrës.

2. Drejtori emërohet nga Ministria e Drejtësisë në pajtim me dispozitat për Shërbimin Civil për emërimin, për pozitat e larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Komisioni profesional vlerësues duhet të përbëhet nga një (1) përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, një (1) përfaqësues nga Zyra e Avokatit të Popullit, nga Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe një (1) përfaqësues nga shoqëria civile.

3. Drejtori emërohet për një periudhë kohore pesë (5) vite me mundësi riemërimi për jo më shumë se një mandat.

4. Drejtori i përgjigjet drejtpërdrejtë Ministrin të Drejtësisë për çështjet që kanë të bëjnë me funksionimin administrativ të Zyrës. Sa i përket hetimeve të bëra nga Zyra, Drejtori duhet të paraqes raport çdo gjashtë muaj te Qeveria e Kosovës, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial si dhe Zyra e Avokatit të Popullit.

Neni 33

Kushtet për emërimin e Drejtorit

1. Drejtori i Zyrës së Përgjegjësisë Disiplinore duhet të përmbushë kualifikimet si në vijim:

1.1. të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;

1.2. të ketë diplomë të vlefshme universitare të fakultetit juridik;

1.3. të ketë tetë (8) vite përvojë pune juridike, prej të cilave pesë (5) vite përvojë pune menaxheriale si dhe të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;

1.4. të ketë reputacion të lartë profesional.

1.5. të mos jetë dënuar për vepër penale.

Neni 34

Inspektorët Disiplinor

1. Inspektorët Disiplinor janë përgjegjës për kryerjen e hetimit disiplinor dhe përfaqësimin e Zyrës para Komisioneve Disiplinore, Këshillave si dhe para Gjykatës Supreme.

2. Detyrën e inspektorit disiplinor mund ta ushtroj personi i cili i plotëson kushtet në vijim:

2.1. të ketë diplomë të vlefshme universitare të fakultetit juridik;

2.2. të ketë pesë (5) vite përvojë pune juridike, si dhe të ketë dhënë provimin e jurisprudencës;

2.3. të ketë reputacion të lartë profesional;

2.4. të mos jetë i dënuar për vepër penale.

3. Drejtori i Zyrës dhe Inspektorët Disiplinor nuk mbajnë përgjegjësi penale për vendimet, mendimet dhe veprimet, brenda fushëveprimit të tyre si staf i Zyrës.

4. Marrëdhënia e punës për Inspektorët Disiplinor, vlerësimi i rezultateve në punë si dhe disiplinimi rregullohen me akt nënligjor të cilin e nxjerr Ministri i Drejtësisë.

Neni 35

Përgjegjësia disiplinore e personelit të Zyrës

1. Drejtori, inspektorët disiplinor respektojnë standardet e përcaktuara me Kodin e Etikës për shërbyesit civil.

2. Staf i administrativ i Zyrës do të disiplinohen, suspendohen dhe shkarkohen në përputhje me legjislacionin për Shërbimin Civil.

3. Shpalosja e paautorizuar e informacioneve të marra gjatë detyrave zyrtare nga personeli i Zyrës përbën shkelje disiplinore pa paragjykuar shkeljet e përcaktuara në legjislacionin për Shërbimin Civil. Sjelljet e tilla të pahijshme mund të qojnë në përgjegjësi disiplinore dhe mund të shërbejnë si bazë për masa disiplinore, përfshirë masat disiplinore të përcaktuara për shkelje serioze sipas legjislacionit për shërbimin civil.

Neni 36

Bashkëpunimi me organet tjera

1. Gjatë kryerjes së funksionit të saj, Zyra bashkëpunon me organet tjera përkatëse duke përfshirë, por duke mos u kufizuar me Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial, Komisionet përkatëse për Vlerësim e performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisionet Disiplinore të Këshillave, Kryetarët e Gjykatave, Kryeprokurorët e prokurorive përkatëse dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës.

2. Të gjitha organet publike obligohen që të ia komunikojnë Zyrës faktet që mund të përbëjnë shkelje disiplinore të një gjykatësi apo prokurori.

3. Nëse ndaj gjyqtarit ose prokurorit është ngritur aktakuzë, kryetari i gjykatës apo kryeprokurori janë të obliguar të njoftojnë menjëherë Zyrën.

3. Me rastin e shqyrtimit të parashtresave dhe pretendimeve sipas dispozitave të këtij ligji, në rastet kur vëren elemente që kanë të bëjnë me performancë të gjyqtarëve dhe prokurorëve Zyra obligohet që të njëjtat pa vonesë ti dërgoj në Këshillat përkatës.

Neni 37

Buxheti

1. Drejtori i Zyrës për Përgjegjësi Disiplinore çdo vit dërgon përmes Ministrisë së Drejtësisë një buxhet të ndarë për financimin e pagave të personelit të Zyrës si dhe shpenzimet e tjera operative të Zyrës.

2. Zyra menaxhon buxhetin e saj në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe bart përgjegjësinë për mbikëqyrjen e shpenzimeve, ndarjen e fondeve, mbajtjen e llogarive të sakta dhe rrjedhëse dhe kryerjen e auditimeve financiare.

Neni 38

Vazhdimi i punës së personelit civil

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të punësuarit në Zyrën e Prokurorit Disiplinor vazhdojnë të punojnë në Zyrën për Përgjegjësi Disiplinore, nëse i plotësojnë kriteret e përcaktuara me dispozitat e këtij ligji.

2. Të punësuarit në Zyrë, të cilët nuk i plotësojnë kriteret ligjore sipas këtij ligji do të kenë një afat shtesë prej dy (2) vite nga hyrja në fuqi e këtij ligji për përmbushjen e kriterëve.

Neni 39

Dispozitat kalimtare

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, parashtrësit dhe çfarëdo informacioni tjetër relevantë në lidhje me sjelljet e pahijshme për gjyqtarë apo prokurorë të paraqitur në Zyrën e Prokurorit Disiplinor si dhe çdo procedurë disiplinore e iniciuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji e cila nuk ka përfunduar ende, do të vazhdon të trajtohet sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji termi “Zyra e Prokurorit Disiplinor”, i përmendur në cilindo ligj apo akt nënligjor në fuqi, nënkupton “Zyra për Përgjegjësi Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë”.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji emërtimet e pozitive prokuror disiplinor dhe inspektor gjyqësor zëvendësohen me inspektor disiplinor.

Neni 40

Hyra në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kadri Veseli

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës